



Datë: 13.09.2019

NJOFTIM PËR REKRUTIM

Ne pajtim me nenin 11 te Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil te Republikës se Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit ne Shërbimin Civil , Administrata Tatimore e Kosovës bënë shpalljen për konkurs të jashtëm:

Titulli i pozitës: Zyrtar i TI-se për Përkrahje(1 pozitë)

Numri i referencës: TIK/470/JP00041023

Përgjegjësi mbikëqyrëse: Jo

I raporton: Udhëheqësit të Divizionit per Operacione dhe Përkrahje

Koeficienti: 7.0 plus shtesat e aplikueshme

Afati i emërimit: Nëpunës i karrierës(përherëshëm), periudha provuese: Dymbëdhjetë(12) muaj.

Vendi i punës: Departamenti i Teknologjisë Informative - Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Zyrtari i Teknologjisë Informative ka objektivë kryesore përkrahjen e nivelit te pare për te gjithë shfrytëzuesit e sistemeve informative duke përfshirë te gjitha aplikacionet dhe sistemet softuerike për shfrytëzues, pajisjet e shfrytëzuesve si: PC, printer, UPS, Lap-Top, skaner, fotokopje, pajisje komunikues ne nivel rrjeti neper zyrat përkatëse. Ne menaxhimin e linjës ofron shërbimet te përkrahjes dhe operacioneve ne zyrën përkatëse duke u siguruar qe te gjithë shfrytëzuesit marrin përkrahjen adekuate çoftë nga niveli i pare i përkrahje çoftë nga nivelet tjera përmes delegimit te kërkesave.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Administron gjitha instalimet, konfigurimet, testimet, mirëmban, mbikëqyr dhe zgjidh problemet e harduerit, softuerit në terminalin e shfrytëzuesit, pajisjet periferike të rrjetit dhe produktet tjera harduerike e softuerike.
- Instalon dhe konfiguron Sistemet Operative (OS), softuerët dhe aplikacionet tjera për te gjithë shfrytëzues e organizatës.
- Monitorimi i funksionimit te pajisjeve te rrjetit, zëvendësimi dhe shtimi i lidhjeve komunikuese, raportimet mbi gjendjen aktuale dhe adresimi i kërkesat eventuale
- Përkrah te gjithë shfrytëzuesit te sistemeve te TI-se ne kuadër te organizatës duke u siguruar qe te gjithë marrin shërbimet përkatëse.
- Identifikimi dhe zgjidhja e problemeve harduerike dhe softuerike ne kompjuter, Lap-top, pajisje tjera printer, fotokopje, skaner, projektor, etj.
- Përkrahje e shfrytëzuesve për përdorim dhe funksionim adekuat te softuerëve, aplikacion baze, portalit si dhe veglave dhe aplikacioneve te tjera te cilat shfrytëzohen ne organizate.

- Përkrah shfrytëzuesit rreth përdorimit të të gjitha pajisjeve të Teknologjisë Informative si dhe sigurohet për funksionim të mirëfilltë, përditësimet (update) adekuat në sistem, përditësimet (Update) të antivirus për të gjithë serverët PC në kuadër të zyrës përkatëse.
- Ofron përkrahje të shfrytëzuesve të ATK-së për sistemet e jashtme (si Trusti, Buxheti, PIP, Tatimit në prone, Thesari, menaxhim të pasurisë/e-pasuria, regjistrin të pengut, etj.)
- Në koordinim me menaxherin e operacioneve dhe përkrahjes, adreson kërkesat dhe përmbush objektivat në afatet kohore duke siguruar përmbushje të standardeve të funksionimit dhe sigurisë për të gjithë shfrytëzuesit.

Kërkesat/Kualifikimet Profesionale:

- Diplomë bachelor në fushat e Teknologjisë Informative ose Telekomunikacion apo fusha të ngjashme, si dhe certifikime në MCSA, ose të ngjashme lidhur me detyrat e pozitës;
- Minimum 2 vite përvojë profesionale në fushën e TI-së;
- Njohuri të mira në të sistemeve operative të Windows-it, PC, pajisje rrjetit, UPS, Printer si dhe në fushën Domeneve, sigurimit dhe aplikacioneve për desktop dhe Ueb aplikacioneve;
- Aftësi për të kuptuar proceset dhe procedurat e punëve që kanë të bëjnë me sistemet e Teknologjisë Informative;
- Aftësi për të punuar në afate të rrepta, në presion të vazhdueshëm dhe për t'u përballur me stresin;
- Shkathtësi shumë të mira kompjuterike, në MS Office (MS Project, Word, Excel, PowerPoint, Visio), etj.
- Të mos ketë dosje penale (të vërtetuar me certifikatë nga gjykata kompetente);

Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Drejtorinë e Përgjithshme të Administratës Tatimore të Kosovës, e cila gjendet në adresën: Këndi i rrugëve "Bill Clinton" dhe "Dëshmorët e Kombit" p.n. në Prishtinë ose në web-faqen e Administratës Tatimore të Kosovës: www.atk-ks.org tek rubrika e punësimit.

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopje të dëshmive të kërkuara sipas Shpalljes për rekrutim dorëzohen në Drejtorinë e Përgjithshme të ATK-së- në Prishtinë në Zyrën e Burimeve Njerëzore.

Aplikacionit duhet bashkëngjitur të dhënat biografike për përvojën paraprake dhe të gjitha kopjet e kualifikimeve (diplomave, certifikatave të trajnimeve, dëshmi të njohjes së gjuhëve të huaja dhe përdorimit të kompjuterit).

Vetëm aplikacionet zyrtare të Administratës Tatimore do të pranohen.

Njoftimi do të jetë i hapur për dorëzimin e aplikacioneve 15 ditë nga dita e publikimit, nga data 13.09.2019 deri me datë 27.09.2019 .

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha Komunitetet në Kosovë.

"Komunitet jo- shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

Aplikacionet e derguara pas dates së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen.

Per shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatet e perzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen.

Per informata shtesë mund të kontaktoni në numrin e tel. 038/200 34 706 .

